



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 32 Datë 25 / 07 / 2025

“PËR MIRATIMIN E SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË PRONË PRIVATE QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE TË FSHATIT QERRET”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2, germa “b” Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 i ndryshuar, VKM nr.138 datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar VKM nr.89 date 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe vleresimin paraprok për këto pasuri. Shkresa me Nr.733/4 prot datë 05.06.2025 të ASHK Durrës-Kavajë-Kruje si dhe vendimin e Keshillit Bashkiak nr.68 datë 23.12.2024 “Për miratimin programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxheti 2025” vendimin e Këshillit Kombëtar të territorit me nr.2 datë 27.04.2018 per PPV për Kavajën, vleresimi paraprak i pasurisë pronë private ku shtrihet investimi dhe gjurma e projektit është bazuar në kartelën e pasurisë dhe gjendjes juridike të saj, të konfirmuara nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës Durrës-Kavajë-Krujë, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshilli Bashkiak mori në shqyrtim dhe:

VENDOSI

1. Nisjen e procedurave ligjore të shpronësimit për interes publik, për realizimin e projektit **“ZGJERIMI I VARREZAVE TË FSHATIT QERRET”** për pasurinë e paluajtëshme të llojit are, në zonën kadastrale 3961 Aganas, që preket nga realizimi i këtij projekti.
2. Nga realizimi i projektit **“ZGJERIMI I VARREZAVE TË FSHATIT QERRET”** preket një pjesë e pasurisë nr.110/18 vol. 2 faqe 247 e llojit “arë” ndodhur në ZK 3961 Agonas e regjistruar në emër të bashkëpronarëve Xherahi sipas listës.
3. Totali i sipërfaqës që do të shpronësohet për interes publik është 2000 m²
4. Vlera paraprake e shpronësimit për interes publik është në shumën 658000 (*gjashtë qind e pesë dhjetë e tetë mijë*) leke e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.
5. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit deri në daljen e VKM-së për shpronësim për interes publik ngarkohen Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të

Aseteve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.

6. Ky Vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.



Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota 26

Vota Pro 26

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28/07/2025

KRYETAR
RUDIN HYLVU

